

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Pro Prot.No:	05-7182
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-03-
Date:	04, 12, 13
Date:	20
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës
Coalition of Refugees of Kosovo

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

DHE

KOALICIONIT TË STREHIMOREVE TË KOSOVËS

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë të cilën e përfaqëson Ministri i Shëndetësisë dhe Drejtori Ekzekutiv i Koalicionit të Strehimoreve të viktimave të dhunës në familje dhe Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore (KSK), i cili përbëhet nga:

1. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve (QMGF) - Prishtinë
2. Shtëpia e Sigurt, (SHES) - Gjakovë
3. Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe të Fëmijëve- Liria - Gjilan
4. Qendra për Mirëqenien e Gruas-QMG - Pejë
5. Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore MVPT Kosovë
6. Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-SDSF Kosovë
7. Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve - Prizren
8. Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe të Fëmijës- QMGF-RABAVOCA – Mitrovicë

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit të subjekteve nënshkruese në trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe fëmijët, viktime të dhunës në familje të trafikimit me njerëz, dhunës seksuale, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe çfarëdo forme tjetër të dhunës.

Neni 2 Fushat e përbashkëta të bashkëpunimit

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të bashkëpunimit do t'i ofroj KSK, në këtë rast strehimoreve që janë anëtare të këtij Koalicioni, mbështetje në ofrimin falas të shërbimeve shëndetësore dhe trajtim psikosocial falas për të gjitha kategoritë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3 Obligimet e MSh-së

1. Ofrimin falas të kujdesit shëndetësor duke përfshirë edhe vizita sistematike
2. Ofrimin e mbështetjes psikosociale përmes ekipeve mobile të psikiatërve, psikologëve, këshilltarët psikosocial që menaxhohen nga Shërbimet Profesionale të Shëndetit Mendor.
3. Ofrimin e mbështetjes nga lista esenciale e barnave në MSH.
4. Ministria e Shëndetësisë siguron barërat sipas kërkesës.
5. Barnat nga lista esenciale mund të ofrohet vetëm në bazë të recetës së mjekut të QKMF ose mjekut të licencuar specialist të Mjekësisë Familjare.

Neni 4 Obligimet e KSK

1. Identifikimin dhe trajtimin e viktimeve të çfarëdo forme të dhunës.
2. KSK bënë kërkesën për barna nga lista esenciale sipas nevojës në baza tre (mujore) dhe vjetore.
3. KSK i ofron MSH listën e shfrytëzuesve të shërbimeve nga neni 3 i kësaj marrëveshjeje, përfshirë dokumentacionin përkatës shoqëruar me recetat, për çdo muaj.

Neni 5 Raportimi

Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës do të raportoj rregullisht në baza tre mujore për aktivitetet e saj në Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 6
Amandamenti i Marrëveshjes

Të dy palët mund të kërkojnë ndryshime në këtë marrëveshje. Modifikimet apo amandamentimet duhet të aprovohen nga të dy palët.

Neni 7
Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme deri në Maj të vitit 2016, me mundësi vazhdimi.
2. Institucionet publike shëndetësore, Departamenti i Shërbimeve shëndetësore, Departamenti Farmaceutik dhe KSK janë të obliguar për zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Marrëveshja nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 1 (një) kopje.

Palët nënshkruajnë këtë marrëveshje në Prishtinë, më _____.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Prof. Dr. Ferid Agani
Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë



**KOALICIONI I STREHIMOREVE
KOSOVË**

Znj. Naime Sherifi
Kryesuese e Koalicionit të
Strehimoreve të Kosovës